



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr. 1173 / 2022

Në bazë të Rregullorës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.01/5349/2020 të datës 31.08.2020 neni 14 pika 14.1.1 dhe neni 15 dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01/Nr.234/2022 të datës 27.01.2022 për ndarjen e mjeteve financiar për bursa për studentët e Komunës së Hanit të Elezit, Drejtoria Komunale për Arsimit, Kulturë Rini dhe Sport shpallë:

**KONKURS
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

Kushtet për aplikim:

- Të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit;
- Të jenë student/e të Universitetit Publik të Kosovës;
- Të jenë student/e të rregullt, por jo me vetëfinancim;
- Të kenë regjistruar vitin;
- Studenti/ja nëse një herë ka përsëritur vitin, humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet);
- Studenti/ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë;
- Studenti/ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejtë aplikimi për bursë;

Prioritetet për kadro deficitare janë Fakultetet:

- Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, stomatologji).
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).**
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).**
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).**
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojtje e Bimëve, Pemëtarë – Vreshtarë, Veterinari, Bioteknologji Ushqimore).
Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).**
- Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë, Fizikë, Kimi),**
- Fakulteti Arteve**
- Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).**

Dokumentet e nevojshme për konkurim;

- a) Çertifikata e notave (me vulë origjinale)
- b) Vërtetimi i semestrit se studenti ka regjistruar vitin akademik 2021/2022 (me vulë origjinale);
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat);
- d) Deklarata e bashkësisë familjare;
- e) Çertifikatën e vendbanimit;
- f) Dëshmia se është; invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale;
- g) Studentë që janë invalid të luftës, anëtarë të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirët e luftës, me gjendje të rëndë sociale. student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat libreza dhe institucionet përkatëse;
- h) Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit;
- i) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës;
- j) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- k) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale);

Afati dhe mënyra e aplikimit;

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit (kati i parë) nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.
Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej datës **16.02.2022** deri më datën **03.03.2022**

Sqarim shtesë: Për bursë kanë prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë. në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores Nr. 01/ 5349/ 2020 do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas Nenit 15 pika 15.1.9.

Vërejtje: Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

